



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 26.12.2014, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N - 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Jelena Bontić, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Mufera Sinik.

Në mbledhje morën pjesë: zyrtarë nga presidenca, përfaqësues të OSBE-së dhe zyrtarët për media të Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Takim me ministrat e ministrive të linjës, lidhur me sfidat dhe prioritetet;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Takim me ministrat e ministrive të linjës, lidhur me sfidat dhe prioritetet

Nait Hasani, kryesuesi i mbledhjes, theksoi se për takimin e sotëm kemi ftuar ministrat që kanë të bëjnë me fushëveprimtarinë e këtij Komisioni, përkatësisht Valon Murati, ministër i Ministrisë së Diasporës dhe Arsim Bajrami, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,

për të folur lidhur me sfidat dhe prioritetet e këtyre ministrive, ndërsa Kujtim Shala, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk mund të marrë pjesë sot, në këtë takim, gjë që ka kërkuar mirëkuptimin e Komisionit. Andaj, urdhëroni ministër, e keni fjalën për të na njoftuar me sfidat dhe prioritetet e Ministrisë së Diasporës.

Valon Murati, ministër i Ministrisë së Diasporës, theksoi se Komisioni dhe Ministria e Diasporës gjenden para një dinamike të ngjeshur pune, ndaj është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë drejt institucionalizimit të mërgatës sonë, e cila ka pasur të arritura, por edhe probleme. Në këtë kontekst, ai përmendi faktin se vetëm 5 për qind e fëmijëve tanë në diasporë janë të përfshirë në mësimin në gjuhën shqipe, që është një shkallë tejet e ulët e përfshirjes. Një sfidë tjetër në këtë lëmë është edhe regjistrimi mërgatës, që është edhe pjesë e strategjisë së kësaj ministrie nga viti 2014, ndër qëllimet e së cilës janë edhe sensibilizimi i opinionit dhe identifikimi i kuadrove në botën e jashtme, pastaj i bizneseve të mërgimtarëve tanë etj. Ndryshimi i Ligjit mbi diasporën është, po ashtu, një detyrë tjetër e rëndësishme.

Ministri Murati foli edhe për hapjen e tri qendrave kulturore, nga ana e Kosovës në Suedi, Zvicër dhe Turqi, si dhe domosdoshmërinë e hapjes së më shumë qendrave të këtilla nëpër shtete të tjera, ku janë më shumë të koncentruar qytetarët tanë. Planifikohet hapja edhe e qendrave të tjera të përbashkëta bashkë me Shqipërinë. Në lëmin e përfshirjes së fëmijëve në shkollim amtar do të bashkëpunohet edhe me Bosnjë-Hercegovinën dhe Serbinë. Murati ishte i mendimit se është i nevojshëm edhe formimi i Komisionit për Mërgatën nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Sali Morina, theksoi se si anëtarë të Komisionit do të japin kontributin për tejkalimin e sfidave me të cilat ballafaqohet Ministria e Diasporës, e në veçanti sa i përket mësimit plotësues në diasporë e cila është një ndër sfidat me të mëdha dhe e cila kërkon një përkushtim të Qeverisë sepse edhe kërkon disa marrëveshje në nivel me të lartë, në mënyrë që ta parandalojmë asimilimin e fëmijëve tanë. Po ashtu buxheti i kësaj ministrie është i kufizuar kur kihen parasysh edhe koston që kërkojnë me rastin e themelimit të Qendrave Kulturore në diasporë. Edhe Ligji për Diasporën dhe Mërgatën duhet të rishikohet në mënyrë që këtë ligj ta bëjmë të zbatueshëm.

Teuta Haxhiu tha se nga diskutimi i ministrit u cekën sfidat dhe prioritetet, andaj kërkoj që themelimi dhe funksionimi i Qendrave Kulturore në diasporë të bëhet me kujdes, udhëheqja e tyre të bëhet nga njerëz profesionalë, e jo partiakë, sfidë tjetër përfshirja e fëmijëve në mësim plotësues, nga vizita në SHBA dhe kontaktet me mërgatën atje kam kuptuar se ka mungesë të Abetareve! Unë, sa i përket Komisionit të veçantë për diasporën, këtë nuk e shoh si pengesë që ne të punojmë, andaj, si Komision, do të japim kontributin tonë në këtë drejtim.

Shpejtim Bulliqi, theksoi se me vëmendje dëgjoj diskutimin e ministrit dhe kërkoi që të kihen vëmendja në disa çështje mjaft me rëndësi siç është regjistrimi i diasporës, gjë që sipas tij, gabimi i parë është bërë që janë ndarë nga regjistrimi i përgjithshëm në Kosovë! Pra ta kemi një shifër afër reales në mënyrë që edhe prioritetet tona për themelim të Qendrave Kulturore të jenë në bazë të numrit të mërgatës tonë atje, ta zëmë themelimi i qendrës në Suedi, ndoshta ma mirë kishte me qenë të themelohet në Gjermani.

Nait Hasani tha se themelimi i qendrës në Suedi është bërë për të gjitha vendet e Skandinavisë.

Ismajl Kurteshi tha se kujdesi ndaj mërgatës duhet të jetë në nivel me të lartë dhe kur ata janë në Kosovë, të mos trajtohen ndryshe nga të tjerët. Ata nga pikat kufitare, ngarkohen me taksa të ndryshme, kanë ankesa në pritjet e gjata para sporteleve në nivel komunal e qendror, për shërbimet që kanë nevojë, ndërsa sa i përket prioritetëve në këtë ministri, sikur unë të isha ai që i përcakton këto atëherë prioriteti im i parë do të ishte që përfshirjen e fëmijëve në mësim plotësues nga 5% do të synoja që ta arrija së paku në 50%, ky do të ishte synimi im kryesor.

Jelena Bontiç, tha se me vëmendje e përcjelli diskutimin e ministrit si dhe strategjinë e tij të punës, konsideroj që Ministria e Diasporës i përket të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, kur është fjala tek kjo ministri duhet të kontribuoj për të gjithë qytetarët kur kihet parasysh që të drejtat e këtyre etnive janë të rregulluara edhe me Kushtetutë.

Shukrije Bytyqi, theksoi se e dëgjoj me vëmendje rezymenë e paraqitur nga ana e ministrit, shpresojmë që shumë shpejt do na sjellë edhe prioritetet e kësaj ministrie, përkrahjen tonë do ta ketë dhe ne do japim kontributin përmes punës në Komision.

Bekim Haxhiu, tha se si institucione në përgjithësi, e në veçanti Ministria e Diasporës duhet ndryshuar qasje ndaj diasporës, sepse më nuk është ajo diaspora e viteve të '70-ta, është zhvilluar, arsimuar, zhvillimi i teknologjisë informative e ka bërë te veten, mësimi plotësues duhet të digjitalizohet për një gjithëpërfshirje më të madhe. Programi i filluar me Shqipërinë për institucionalizimin e mësimin plotësues në diasporë duhet të vazhdojë, po ashtu programe të tilla edhe për etnitë e tjera, duhet ofruar kushte dhe hapësirë për investime me të mëdha të diasporës, por natyrisht edhe duke ju ofruar edhe siguri.

Nait Hasani, falënderoi ministrin për pjesëmarrjen e tij në mbledhje dhe shprehu gatishmërinë e Komisionit për bashkëpunim në të gjitha çështjet që do të shqyrtohen para këtij Komisioni. Tani mbledhjen e vazhdojmë me diskutimin e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, shpresojmë që vitin e ardhshëm do të kemi tejkalim të sfidave që jemi ballafaquar në vitin 2014 në të gjitha nivelet e arsimit, për vitin 2015 besoj që do ta kemi një strategji për dalje nga kjo gjendje dhe mundësi për përgatitje të gjeneratës së re për zhvillim të vendit.

Arsim Bajrami, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën. Tha se kjo ministri në fushëveprimin e vet ka tri fusha shumë të rëndësishme, siç janë: arsimi, shkenca dhe teknologjia. Në këtë frymë, duke folur për çështjen e arsimit në të gjitha nivelet, ministri Bajrami tha se ngritja e cilësisë së arsimit duke filluar nga niveli parashkollor e deri të arsimit të lartë, pa lënë anash, natyrisht, edhe zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit është e një rëndësie të veçantë, duke ditur se brezat e rinj janë e ardhmja jonë. Ministri i bëri një vështrim të veçantë edhe gjithëpërfshirës së fëmijëve në shkollim, pastaj humanizmit të mëtejme të shkollimit, nevojës së progresit në aspektin teorik e praktik të mësimdhënies etj. U zotua se do të bashkëpunojë ngushtë me Komisionin Parlamentar për Arsim, në mënyrë që së bashku të bëjnë më të mirën për zhvillimin e proceseve dhe projekteve në arsim.

Nait Hasani tha se si anëtarë të Komisionit, por edhe si shoqëri pa përjashtim kemi nevojë për një arsim cilësor, një arsim që i shërben shoqërisë sonë, duke filluar që nga arsimi parashkollorë, arsimi parauniversitar, universitar. Si komision do të mbështesim për tejkalimin e sfidave dhe për

ato që ju i prezantuat ju, jemi të gatshëm për bashkëpunim edhe në nismat që mund t'i ndërmerreni qoftë në ndryshimin apo hartimin e projektligjeve.

Teuta Haxhiu – Theksoi se cilësia në arsim duhet të jetë prioriteti i parë, kemi ndërtuar mjaft objekte shkollore, është koha që investimet tona të përqendrohen në ngritjen e cilësisë, andaj investimet në arsimin parauniversitar duhet të rriten, sepse këtu vihen themelet e nxënies, sepse kemi moshën ideale të fëmijëve. Po ashtu sfidë tjetër, në këtë segment mbetet inspektorati i arsimit ku ballafaqohet me numër të pamjaftueshëm, kemi gjithësejt 54 inspektorë në Kosovë, p.sh. në Gjakovë asnjë inspektor nuk është me përgatitje nga fusha e matematikës dhe është shumë sfidë se si ai bën monitorim nga kjo lëndë, sa është real, sepse këto inspektime kanë rendësi sepse e rrisin përgjegjësin e mësimdhënësve. Buxheti që ndahet për shkencë, më vjen mirë që keni planifikuar me ndryshuar qasjen për shfrytëzim të atij fondi. Ndërsa krejt në fund një pyetje për ju, të cilën e ka bërë edhe në mandatin e kaluar, e që ka të bëjë me themelimin e gjimnazit matematikor në Prishtinë, ka qenë projekt i mëhershëm, ku ka mbetur dhe se a ka shpresa me u implementuar?

Shukrije Bytyqi tha se pret që të jetësohen prioritetet të cilat i prezantoi z. Bajrami, ndërkohë që kërkoi t'i kushtohet kujdes i duhur edhe institucioneve parashkollore e në veçanti të angazhohet për rritjen e numrit të stafit që do të punojë në këto institucione. Për shembull kemi rastin e Komunës së Malishevës, ku kemi objektin, por kemi mungesë të stafit, gjë që disa herë drejtorja komunale ka bërë kërkesë për staf në mënyrë që të fillojë punën ky institucion, por nuk kemi përgjigje pozitive, andaj kërkoj nga ju që të merreni seriozisht me këtë problematikë. Një problem tjetër është në sistemin arsimor, është edhe përshtypja që u krijua për mos përsëritjen e vitit shkollor, gjë që mandej në shkallë me të larta po kemi nxënës që nuk dinë shkrim e lexim. Duhet të investojmë në mjetet e konkretizimit, praktikë profesionale të ketë me tepër, ndërsa në sistemin e arsimit të lartë janë hapur universitete e drejtime për të cilat nuk janë bërë studime të mirëfillta se çfarë kuadrove i nevojiten vendit, ose cilat janë kuadrot deficitare e që mund të jenë Hoteleria e Turizmi.

Shpejtim Bulliqi theksoi se për t'u arritur cilësia në arsim, atëherë duhet fillimisht që të plotësojmë mungesën e gjërave elementare për një mësimdhënie me standarde, ta zëmë deri më sot nuk ka asnjë kontingjent të Hartave të blera në Kosovë për shkollat tona që do të shërbenin edhe si mjete të konkretizimit, pra orientimi i mëhershëm ka qenë vetëm në ndërtim objektesh. Çështje tjetër me rendësi është decentralizimi, e në veçanti në arsimin e lartë që është i domosdoshëm për dekanatet, shefat e departamenteve nuk janë në pozicionet që njihen. Po ashtu çështje e Kurrikulave është një fushë ku duhet shikuar me urgjencë, sepse shumë nga fushat janë bërë nga dominimi i caktuar dhe po ashtu fare në fund çështja e fondit për shkencë ka pasur shumë të meta! Ai fond nuk është shpenzuar aty ku është dashtë të shpenzohet, e ku bëhet shkencë. Në projektligjin për Buxhetin e vitit 2015 ishte paraparë një fond për Universitetet Publike, por jo edhe për Universitetin e Prishtinës, gjë që mendoj se edhe UP është dashtë ta ketë një fond të tillë.

Ismajl Kurteshi tha se cilësia në arsim duhet të jetë prioritetet, andaj do duhet që inspektoratit të arsimit duhet t'i jepen edhe më shumë kompetenca, në mënyrë të gjeturat e tyre që nga kontrollat që i bëjnë të mos mbesin në nivel të konstatimeve, por edhe të sanksionohen ata që nuk kanë standarde në mësim. Po ashtu decentralizimi ndikon pozitivisht në përmirësimin e gjendjes, çështje tjetër që duhet përmendur është bashkëpunimi i MASHT të Kosovës dhe Ministrisë së

Arsimit të Shqipërisë në avancimin e arsimit të dy vendeve. Çështja e integritetit të minoritetit serb duhet të kontrollohet nga institucionet tona, se ne investojmë në këtë çështje t'i respektojnë plan- programet e Kosovës, sepse edhe paguhet nga buxheti jonë. Çështje tjetër me rëndësi janë shkollat dhe kolegjet private, ato kanë autonomi të plotë dhe po i bëjnë shumë dëme gjeneratave të reja, deri në fillim të muajit dhjetor bëjnë reklama për regjistrim të studentëve, a në ndërkohë në tetor ka filluar viti akademik, cilësia në to është shumë e dobët, nuk ka as edhe një rast të vetëm që studentët e humbin vitin në këto kolegje.

Sali Morina theksoi se çështja e kolegjeve, apo bartësve privat të arsimit të lartë duhet të rregullohet një herë e mirë, monitorimi duhet të jetë i mirë dhe inspektorati duhet të fuqizohet me kapacitete dhe kompetenca. Një çështje që më duhet ta diskutoj tani ka të bëjë me fondin për libër, në mënyrë që të mos kemi dualizëm me Ministri të Kulturës të unifikohet si fond mos të bëjmë dualizëm, sepse aktualisht të dy ministrat kanë fondin për libër.

Bekim Haxhiu tha se për të satën herë po e shpreh si shqetësim peshën e rëndë të çantave disa që bartin nxënësit tanë janë të sterngarkuara, ndoshta është mirë të shikohet kurrikula shkollore në mënyrë që të paktën librat të ndahen në dy pjesë sipas plan programeve të gjysmë vjetorit të parë dhe të dytë, kjo ndarje ndoshta për 50% do t'i lehtësonte çantat e nxënësve. Po ashtu duhet rishikuar edhe përmbajtja e teksteve që mësojnë nxënësit tanë, ta zëmë përmbajtja e librit të historisë është e pa pranueshme që atë ta mësojnë fëmijët tanë. Të gjithë ndoshta pajtohemi që arsimi i lartë është i rregulluar me një Ligj të dobët, i cili me doemos duhet rishikuar dhe harmonizuar me legjislacionin tjetër që rregullon marrëdhënien e punës. Duhet shikuar mundësinë që edhe në Ligjin e Maturës të bëhen disa përmirësime, sepse një fëmijë apo nxënës i moshës 18 vjeçare brenda një muaji i duhet t'i nënshtrohet tri provimeve të rënda që është tepër ngarkesë.

Muferra Sinik theksoi se dëshiron të njoftohet me tepër nga ministri lidhur me funksionimin e shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla meqë edhe vetë është mësimdhënëse dhe rolin e këtij shërbimi e sheh si mjaft të rëndësishëm.

Anëtarët e Komisionit, si dhe ministri Bajrami, u angazhuan për domosdoshmërinë e krijimit të një baze të avancuar në arsimin parauniversitar, i cili do të reflektohet pastaj pozitivisht në arsimin universitar. Për të arritur këtë është e nevojshme që të bëhen edhe ligje sa më të mira për arsimin në përgjithësi. Ligji duhet të forcojë autonominë e universiteteve, pa harruar edhe nevojën e menaxhimit sa më të mirë të tyre, si dhe sigurimin e një buxheti, i cili mundëson një reformë rrënjësore në universitete. Gjatë diskutimeve u shtrua edhe nevoja e një mbikëqyrjeje sa më të mirë të procesit të mësimdhënies.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani